
BASHKËPUNIMI TERRITORIAL: ALEANCË RECIPROKE MIDIS ZONAVE URBANE DHE RURALE TË BASHKISË TIRANË

ORNELA HASRAMA

Universiteti i Tiranës,
ornela.hasrama@fhf.edu.al

SONILA SINJARI (XHAFI)

Universiteti i Tiranës,
sonila.xhafa@fhf.edu.al

ERVIS KRYMBI

Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”,
ervis.krymbi@unishk.edu.al

EDLIRA □ ARO (KOLA)

Universiteti i Tiranës,
edlira.kola@fhf.edu.al

Abstract

Territorial developments are regarded as endogenous and spatially integrated forces, which rely on the contribution of decision-making actors, bringing value to social and economic growth at the national level. In Albania, current developments are attributed to rapid urbanization and the growing disparities between urban and rural areas, prompting territorial cooperation to emerge as a key mechanism for promoting the harmonization of development policies and sustainable spatial growth. This territorial cooperation is seen as a strategic tool for establishing a reciprocal alliance between the city and rural areas. The territorial alliance is already evident in the Municipality of Tirana, where the periphery serves as a complementary relationship for the city, while the city, in turn, acts as an attractive hub for the services and functions needed by rural areas, creating a reciprocal territorial relationship between them. To understand the reciprocal territorial cooperation between different geographical spaces, rural – urban and rural – rural, within the Municipality of Tirana, this article analyzes the developments of the “center” and “periphery,” the complementary and dependent relationships between territories, the role of local actors, as well as the challenges

for productive territorial cooperation. The promotion of reciprocal territorial relations is directly linked to the contribution reflected in social cohesion, improved infrastructure, and the economic empowerment of rural communities or the complementarity of urban areas, ensuring more balanced and inclusive development throughout the entire territory of the Municipality of Tirana.

Keywords: reciprocity, decentralization, local communities, autonomous territories, balanced development, territorial alliances, development policies.

Hyrje

Reciprociteti territorial është një prej marrëdhënieve më komplekse të një hapësire gjeografike, pasi krijohen lidhje bashkëpunimi në disa kontekste, si në aspektin ekonomik, social, kulturor, apo edhe politik. Duke marrë në konsideratë varësitë territoriale, flukset e lëvizjes ditore së popullsisë, si dhe shkëmbimet midis territoreve, mund të bëhet një prognozë për zhvillimin e këtyre hapësirave. Në një tjetër këndvështrim, këto dinamika dhe procese që zhvillohen në një territor, si: zhvendosjet e popullsisë për arsye punësimi dhe arsimimi, varësitë territoriale, shfrytëzimi i hapësirës publike urbane apo rurale, zhvillimi i turizmit, ushtrimi i bujqësisë dhe artizanatit, apo edhe shfrytëzimi i shërbimeve të ndryshme, bëjnë të mundur që këto hapësira të kenë mundësinë e ndryshimit të profilit të tyre socio – ekonomik si hapësira territoriale autonome. Një faktor shumë i rëndësishëm, që luan rol në plotësueshmërinë dhe ndërvarësinë territoriale, është distanca gjeografike. Arsyeja përse kjo distancë konsiderohet si avantazhuese ose dizavantazhuese, veçanërisht në kontekstin e zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik, midis dy apo më shumë territoreve, lidhet me kostot kohore dhe financiare të produktit që ndërlihdh këto hapësira me njëra – tjetrën. Këto kosto transporti konsiderohen si baza e atraktivitetit ekonomik midis hapësirave, sepse nxitin një diferencim domethënës të zonave të ndryshme, duke shprehur dukshëm intensitetin e marrëdhënies midis territoreve¹. Nga ana tjetër, edhe aspekti social ka një peshë të konsiderueshme në plotësueshmërinë dhe ndërvarësinë midis territoreve. Janë pikërisht faktorët si shërbimet shëndetësore, arsimi cilësor, furnizimi ushqimor apo edhe argëtimi, të cilët e tërheqin popullsinë e një territori drejt qendrave kryesore të zhvilluara. Gjithashtu, edhe faktorët e lartpërmendur politikë apo kulturorë, kanë të njëjtin ndikim në zhvillimin territorial. Kështu, p.sh., politikat lokale dhe kombëtare ndihmojnë në vendimet për përdorimin e tokës, planifikimin urban dhe zhvillimin e infrastrukturës, përcaktimin e zonave funksionale, të cilat përshpejtojnë ose pengojnë zhvillimin e

¹ Regnacq. Ch, "Impact d'un risque technologique majeur dans l'attractivité des territoires", *Hyper Article en Ligne - Sciences de l'Homme et de la Société*, 2018, f. 10, <https://hal-univ-pau.archives-ouvertes.fr/hal-02141061/document>.

territorit. Po ashtu, decentralizimi ose centralizimi ndikon në mënyrën se si merren vendimet dhe si shpërndahen burimet midis zonave urbane dhe rurale. Në sistemet e centralizuara, zhvillimi është shpesh i përqendruar në qendrat urbane, ndërsa qeverisja e decentralizuar lejon një zhvillim më të balancuar rajonal. Njëkohësisht, faktori kulturor mund t'i japë përparësi ruajtjes së peizazhit gjeografik, të trashëgimisë kulturore, si dhe të ndikojë në modelet e migrimit, duke nxitur urbanizimin e qendrës dhe depopullimin e zonave rurale.

Rishikimi i literaturës

Që prej fillimit të viteve 2000, kërkuesit shkencorë kanë tentuar të kuptojnë më mirë proceset që promovojnë integrimin socio – ekonomik në Europë dhe barazinë shoqërore përmes kufijve shtetërorë, duke u nisur nga territori i tyre². Në të njëjtën kohë, ndjesia e fortë e identitetit territorial lokal mund të forcojë kapacitetet për bashkëpunim të rrjetëzuar, duke përfshirë shumë qytete dhe rajone dinamike dhe rezistente³. Si rezultat, debati lidhur me integrimin ekonomik, social dhe politik ka nxitur interes akademik, duke u orientuar drejt politikave, për të kuptuar më mirë marrëdhëniet e ndërsjellta midis proceseve të integritetit europian dhe bashkëpunimit lokal, rajonal dhe kombëtar⁴. Në terma të përgjithshëm, bashkëpunimi territorial përfshin një grup procesesh, parimesh dhe rregullimesh organizative midis dy ose më shumë territoreve apo njësive, të cilat synojnë arritjen e objektivave bazë për zhvillimin reciprok territorial^{5, 6}. Në kontekstin e Bashkimit Europian, bashkëpunimi territorial ka të bëjë me reduktimin e pabarazive midis rajoneve, forcimin e kohezionit

² Medeiros. E, Scott. J, Ferreira. R, Boijmans. P, Verschelde. N, Guillermo-Ramírez. M, Soares. A, "European territorial cooperation towards territorial cohesion?" *Regional Studies* 58, no. 8, 2023, f. 1518–1529, <https://doi.org/10.1080/00343404.2023.2226698>.

³ Capello. R, "Cohesion policies and the creation of a European identity: The role of territorial identity", *JCMS: Journal of Common Market Studies* 56, no. 3, 2018, f. 489–503, <https://doi.org/10.1111/jcms.12611>.

⁴ Durand. F, Decoville. A, "A multidimensional measurement of the integration between European border regions", *Journal of European Integration* 42, no. 2, 2020, f. 163–178, <https://doi.org/10.1080/07036337.2019.1657857>.

⁵ Beck. J, "Transdisciplinary Discourses on Cross-Border Cooperation in Europe", *Peter Lang Bruxelles*, 2019, f.13.

⁶ Guillermo-Ramírez. M, "The added value of european territorial cooperation: Drawing from Case Studies", *European Territorial Cooperation*, edited by E. Medeiros, 2018, f. 25–47.

social dhe inkurajimin e zhvillimit ekonomik optimal⁷. Pikërisht, duke iu referuar dispozitave të Bashkimit European, lidhur me fushat e lartpërmendura, shumë vende po orientohen drejt një zhvillimi territorial në bashkëpunim.

Bashkëpunimi territorial, i njohur ndryshe edhe si “aleanca territoriale”, është një tematikë e kthyer gjithnjë e më shumë në vëmendjen e aktorëve lokalë për zhvillimet rajonale, si rezultat i përfitimeve që sjell në progresin e vazhdueshëm të territoreve të përfshira në këtë marrëdhënie reciproke hapësinore. Bashkëpunimi u mundëson rajoneve dhe qyteteve të trajtojnë sfidat e përbashkëta që nuk mund t’i zgjidhin vetëm, duke bashkuar në këtë mënyrë burimet natyrore, humane dhe financiare, si dhe ekspertizën e tyre⁸. Kjo ndikon në mënyrë të drejtpërdrejtë në rritjen ekonomike, përfshirjen sociale, si dhe mbrojtjen më të mirë të mjedisit⁹. Megjithatë, bashkëpunimi përballet edhe me disa sfida që duhet të merren parasysh për të siguruar suksesin e tij. Një nga risqet kryesore është ekzistenca e dallimeve në kornizat ligjore dhe kapacitetet financiare midis rajoneve dhe qyteteve pjesëmarrëse në këtë bashkëpunim¹⁰. Megjithatë, faktorët sfidues janë në varësi të kushteve që ndodhet një hapësirë gjeografike, dhe për sa kohë faktorët human dhe natyrorë nuk janë të njëjtë, secili prej territoreve duhet trajtuar më vete.

Në ditët e sotme, aleanca territoriale po synohet të arrihet në një kohë kur konkurrenca është më e lartë, pavarësisht se në thelb kjo alencë valorizon dhe njeh potencialet territoriale, në kontekstin e plotësueshmërisë, për hapësira të ndryshme gjeografike, si për metropolet, qytetet e vogla, apo edhe për zonat suburbane dhe rurale. Qëllimi i vërtetë i kësaj aleance është bashkëpunimi territorial. Ky bashkëpunim konsiderohet i rëndësishëm në disa aspekte, veçanërisht në kontekstin ekonomik, pasi ndihmon në zbehjen e barrierave tregtare, investimeve, apo edhe zhvillimit të infrastrukturës duke ndikuar drejtpërdrejt në rritjen ekonomike të dy apo më shumë hapësirave gjeografike.

⁷ McMaster. I, Maguire. R, “Territorial cooperation: Widely pursued and widely questioned”, *EoRPA Report 23/4, European Policies Research Centre*, University of Strathclyde and EPRC Delft, 2023, https://eprc-strath.org/wp-content/uploads/2023/12/Territorial-Cooperation-EoRPA-report-23_4-ISBN.pdf.

⁸ Chamusca. P, "Territorial cooperation and cross-border development: The Portuguese dynamics", *Social Sciences* 13, no. 2, 2024, f. 108, <https://doi.org/10.3390/socsci13020108>

⁹ While. A, Gibbs. D, Jonas. A, "The competition state, City-Regions, and the territorial politics of growth facilitation", *Environment and Planning A: Economy and Space* 45, 2013, 2379–98.

¹⁰ Gasparini. A, "Belonging and identity in the European border towns: Self-centered borders, hetero-centered borders", *Journal of Borderlands Studies* 29, 2014, f. 165–201, doi:10.3390/ijgi7030111 www.mdpi.com/journal/ijgi.

Aleanca territoriale bazohet në katër çështje të zhvillimit lokal të territorit¹¹. Katër dimensionet e aleancës territoriale lidhen me:

- *Zhvillimin ekonomik të hapësirës gjeografike*: nëpërmjet bashkëpunimit krijohen mundësi të reja, të cilat përkthehen në vende të reja pune.
- *Atraktivitetin e territorit*: bashkëpunimet japin mundësinë që territoret të rivitalizohen dhe të tërheqin kërkesat nga jashtë.
- *Kohezionin social*: bashkëpunimet bëjnë të mundur që aktorë të ndryshëm të bëhen bashkë për të njëjtin qëllim, ku nëpërmjet njohjes së sfidave respektive, punojnë bashkë për të ndërtuar zgjidhje të reja për territorin.
- *Cilësinë e jetës*: këto bashkëpunime janë burime të projekteve që përmirësojnë mjedisin dhe kushtet e jetesës së banorëve të saj.

Aleanca territoriale evidenton katër objektiva të rëndësishëm, të cilat lidhen me ndërveprimin e aktorëve të ndryshëm, si krijimi i bashkëpunimeve midis: sipërmarrjeve ekonomike¹², autoriteteve vendore¹³, aktorëve ekonomikë¹⁴, si dhe bashkëpunimit me fondacionet¹⁵. Në dekadën e fundit, praktikatat e bashkëpunimit janë diversifikuar. Të katër objektivat e cituar përkthehen në ekuilibrim të performancës dhe angazhimit, hibridizimit të modeleve socio-ekonomike, nxitjes dhe përsheptimit të inovacionit shoqëror, si dhe zhvillimit territorial. Këto janë disa nga arsyet që shpjegojnë përse përqindja më e madhe e sipërmarrësve praktikojnë të paktën një formë bashkëpunimi midis aktorëve të ndryshëm. Këto bashkëpunime konsiderohen të dobishme për të zvogëluar risqet dhe për të bërë të mundur zhvillimin e një ekonomie të qëndrueshme.

¹¹ Sibieude. Th, «Les Alliances Qui Changent les Territoires: Partenariats Entre Acteurs Publics, Acteurs Privés et Structures d'Intérêt Général pour le Bien Commun », 2020, <https://impactinitiative.essec.edu/index.php/developpement-local/>.

¹² Secrétariat d'Etat chargé de l'économie sociale et solidaire et de la vie associative, Acteur: Les Associations, *Fiche Pratique du "Faire Alliance"*, 2022, <https://www.lerameau.fr/wp-content/uploads/2022/09/Fiches-Pratiques-Associations-EXE.pdf>.

¹³ Secrétariat d'Etat chargé de l'économie sociale et solidaire et de la vie associative, «Acteur: Les collectivités territoriales », *Fiche Pratique du "Faire Alliance"*, 2022, <https://www.lerameau.fr/wp-content/uploads/2022/09/Fiches-Pratiques-Collectivites-EXE.pdf>.

¹⁴ Secrétariat d'Etat chargé de l'économie sociale et solidaire et de la vie associative, «Acteur: Les Entreprises », *Fiche Pratique du "Faire Alliance"*, 2022, <https://www.lerameau.fr/wp-content/uploads/2022/09/Fiches-Pratiques-Entreprises-EXE.pdf>.

¹⁵ Secrétariat d'Etat chargé de l'économie sociale et solidaire et de la vie associative, «Acteur: Les Fondations», *Fiche Pratique du "Faire Alliance"*, 2022, <https://www.lerameau.fr/wp-content/uploads/2022/09/Fiches-Pratiques-Fondations-EXE.pdf>.

Metodologjia

ArcGIS Survey123 është një zgjidhje në krijimin, ndarjen dhe analizimin e pyetësorëve të cilët përdoren gjerësisht në kërkimet shkencore. ArcGIS Survey123 është një aplikacion i Sistemeve Gjeografike të Informacionit (SIG) i strukturuar për pyetësor në terren, duke përfshirë mbledhjen, analizimin dhe raportimin e të dhënave në kontekstin gjeografik në një pajisje “smart” (p.sh., smartphone, kompjuter, tablet). Këto pajisje moderne janë në gjendje të arrijnë pozicionim gjeografik të spikatur në cilësi shumë të mirë^{16, 17}. Për këtë kërkim shkencor u ndërtua një pyetësor, i cili u realizua pikërisht nëpërmjet ArcGIS Survey123. Krijimi i hartave online në një aplikacion të tillë është gjithashtu tërheqës krahasuar me versionet e mëparshme të SIG, si dhe më miqësore për përdoruesin¹⁸. Kjo metodë u mundëson studentëve të kuptojnë më lehtë se si vëzhgimet në një zonë gjeografike lidhen me pozicionin gjeografik përmes platformës digjitale të programuar në mjediset e tyre mobile¹⁹.

Pyetësori u kompozua me 12 pyetje, një kombinim i pyetjeve të hapura dhe të mbyllura, me qëllimin për të mbledhur të dhëna sasiore dhe cilësore në kohë reale, duke u fokusuar në perceptimet e të anketuarve, banorë në zonat rurale të bashkisë Tiranë, lidhur me bashkëpunimin midis zonave urbane dhe rurale të këtij territori. Të dhënat u mbledhën në terren duke përdorur aparate celulare që suportojnë GIS Survey 123. Për të kuptuar marrëdhënien reciproke midis territoreve rurale – rurale dhe rurale – urbane, përgjatë javës së katërt të muajit maj (2024) u realizuan 108 anketime në zonat rurale të bashkisë Tiranë (Vaqqarr, Pezë, Farkë, Kashar, Dajt, Shëngjergj, Zall – Herr). Pasi të dhënat u grumbulluan, ato u analizuan duke përdorur mjete GIS për të identifikuar modelet gjeohapësinore të bashkëpunimit territorial midis zonave të ndryshme të bashkisë. Përmes përdorimit të ArcGIS-it, u krijuan harta tematike dhe raporte të detajuara, të cilat mbështetnin argumentet e punimit.

¹⁶ Dabovë, P, Pietra. V. D, Piras, M. "GNSS positioning using mobile devices with the android operating system", *ISPRS International Journal of Geo-Information* 9, 2020, f. 220, <https://www.mdpi.com/2220-9964/9/4/220>.

¹⁷ Sinjari, S, Kosovrasti, A, "Geography Students' fieldwork with ArcGIS Survey123 for the assessment of human pressure in protected areas", *Studime Albanologjike*, no. 1, 2023, ISSN Print 2305-3828, ISSN Online 2959-9695, f. 34, <https://studimeapi.gridcoding.com/uploads/materials/1703590967219.pdf>.

¹⁸ Fargher, M, "WebGIS for Geography Education: Towards a GeoCapabilities Approach", *ISPRS International Journal of Geo-Information* 7, 2018, f. 111.

¹⁹ Sinjari, S, Kosovrasti, A, "Geography Students' fieldwork with ArcGIS Survey123 for the assessment of human pressure in protected areas", *Studime Albanologjike*, no. 1, 2023, ISSN Print 2305-3828, ISSN Online 2959-9695, f. 34, <https://studimeapi.gridcoding.com/uploads/materials/1703590967219.pdf>.

Rezultate dhe diskutime

Zhvillimi aktual i zonave “qendër” dhe “periferike” të bashkisë Tiranë


Profili ekonomik i njësive administrative rurale të bashkisë Tiranë ka pësuar një evolucion të vazhdueshëm lidhur ngushtë me kushtet territoriale dhe politikat e ndjekura nga aktorët lokalë për zhvillimin e këtyre hapësirave. Në Shqipëri, termi “periferi” është përdorur kryesisht për t’iu referuar zonave rurale të vendit, pra si një nocion kontrastues i zonave urbane. Më konkretisht, në nivel bashkie, 11 njësitë administrative urbane të Tiranës janë konsideruar si zona “qendër” dhe 13 njësitë administrative rurale si zona “periferike”. Zhvillimet e ditëve të sotme kanë bërë të mundur krijimin e modeleve të reja rreth konceptit qendër – periferi, ku në disa raste zonat qendrore apo urbane shërbejnë mirëfilltazi si “qendër”, ndërsa në raste të tjera të veçanta, janë vetë zona të caktuara rurale që shërbejnë si “qendër” për zona të tjera rurale. Për të zbërthyer këtë marrëdhënie territoriale, në hapësirën gjeografike të bashkisë Tiranë, mund ta kategorizojmë intensitetin e ndikimit të qendrës në tri shkallë apo rreze (i lartë – i mesëm – i ulët). Nëse do ta realizonim kategorizimin e territorit në tri rreze ndikimi, të shtrira nga zona urbane e Tiranës në drejtim të zonave rurale, në kontekstin ekonomik, por duke evidentuar edhe rolin e faktorit distancë dhe atij natyror, do të përfitonim një zonim të territorit periferik si vijon:

Rreze 1. Kashar – Vaqarr – Farkë – Dajt – Zall Herr²⁰

Rreze 2. Ndroq – Pezë – Petrelë – Bërzhitë

Rreze 3. Baldushk – Krrabë – Shëngjergj – Zall Bastar

Figura 1. Rrezet e ndikimit nga zona urbane e Tiranës në drejtim të zonave rurale



Burimi: Ilustrim i autorëve

20 Me përjashtim të pikës më të lartë të territorit të bashkisë Tiranë – Mali i Dajtit.

Duke qenë se kategorizimi i njësive rurale të bashkisë Tiranë ka marrë në konsideratë edhe profilin e tyre ekonomik, përgjatë analizës, do të ruhet i njëjti kategorizim, me qëllim evidentimin e faktorëve ndikues dhe interpretimin e evolucionit territorial.

Rrezja e parë e ndikimit të qendrës së Tiranës drejt njësive rurale, janë pikërisht njësitë administrative rurale Kashar – Vaqarr – Farkë – Dajt – Zall Herr. Në këto zona, ndikimi i qendrës është shumë i lartë lidhur ngushtë me pozitën gjeografike e këtyre njësive territoriale. Ky ndikim është konstatuar jo vetëm në zhvillimin progresiv të zonave, por njëkohësisht edhe në transformimin territorial, social dhe ekonomik të tyre. Nga ky grupim, një prej hapësirave gjeografike të transformuara është njësia administrative Kashar. Aktualisht në këtë njësi administrative janë të vendosura bizneset më të rëndësishme në nivel vendi, si në fushën e shërbimit dhe në atë të prodhimit. Këto zhvillime kanë ndikuar në rritjen e nivelit të të ardhurave të njësive administrative dhe të transformimit të peizazhit gjeografik, por nga ana tjetër edhe të transformimeve territoriale të zonës. Si rezultat i pozitës gjeografike, e konsideruar si shumë e favorshme, Kashari ka pësuar një urbanizim me ritme shumë të shpejta. Zhvillimi i vrullshëm i hapësirës përgjatë aksit rrugor Tiranë – Durrës ka krijuar një peizazh të ri të kompozuar me shumë ndërtime industriale, të transportit, shërbimeve, banimit, etj., duke mos u identifikuar si zona funksionale specifike, por duke krijuar një zonë mikse mjaft diverse. Njësia administrative Dajt ka një dominim të ekonomisë bujqësore, ku rëndësi të veçantë ka blegtoaria, e cila mbështetet në sipërfaqet e konsiderueshme me pyje dhe kullota. Sektorë me perspektivë për të ardhmen e zonës janë turizmi, artizanati, agroindustria, apo edhe ndërtimi²¹. Megjithatë, në vazhdimësi, kjo njësi administrative mund të pësojë një përmbysje të profilit mbizotërues të ekonomisë, duke u shndërruar nga zonë bujqësore në zonë shërbimesh dhe turizmi, si rezultat i zhvillimeve që njësia administrative ka marrë në vitet e fundit. Në të njëjtat kushte ndodhen edhe njësitë administrative rurale të Farkës dhe Vaqarrit, ku profili ekonomik mbizotërohet nga bujqësia, por që tashmë mund t'i evidentojmë si dy zona me zhvillim të pandërprerë në shërbime dhe si zona rezidenciale të preferuara. Situata shfaqet ndryshe në rastin e njësive administrative Zall-Herr. Ndonëse, sipas kategorizimit të kryer, Zall-Herri përfshihet në po të njëjtën rreze të ndikimit të qendrës si njësitë administrative të lartpërmendura, kjo njësi paraqitet si një zonë tipike rurale, me mbizotërim të bujqësisë dhe agroturizmit. Në këtë rast, treguesit mbeten të njëjtë, por ky dallim i zonës me tendencat ekonomike

²¹ Kosovrasti. A, Zhvillimi i qëndrueshëm i komunave Dajt dhe Bërzhitë (studim krahasues), *Disertacion*, Universiteti i Tiranës, 2014, f. 24, <https://unitir.edu.al/wp-content/uploads/2014/09/Doktoratura-Albana-Kosovrasti-Fakulteti-i-Historise-dhe-i-Filologjise-Departamenti-i-Gjeografise.pdf>.

të njësive të tjera të së njëjtës rreze vjen si rezultat i mungesës së infrastrukturës optimale për zhvillimin e territorit.


Rrezja e dytë e ndikimit, me njësitë administrative Ndroq – Pezë – Petrelë – Bërzhitë, mund të evidentohet si një kategori me profil ekonomik më homogjen. Kryesisht aktiviteti ekonomik mbizotërues është bujqësia dhe blegtoria, por me një tendencë zhvillimi të sektorit të tretë të ekonomisë, veçanërisht të turizmit. Njësia administrative e Ndroqit, zonë rurale bujqësore, evidentohet për prodhimin e vajit të ullirit, ku zhvillojnë aktivitetin e tyre 8 fabrika prodhimi. Nga ana tjetër, aktorët lokalë shpeshherë kanë organizuar panaire të produkteve bujqësore e blegtorale të zonës për promovimin dhe nxitjen e agroturizmit në këtë njësi administrative. Po ashtu, edhe njësia administrative e Bërzhitës ka potenciale prodhuese dhe asete me vlera. Zhvillimi ekonomik mbështet te bujqësia, blegtoria, frutikultura dhe ullishtat, si rezultat i kushteve të favorshme natyrore dhe traditës së zonës. Prodhimi më intensiv bujqësor realizohet në zonën fushore përgjatë luginës së lumit Erzen. Prodhimet bujqësore zënë vendin kryesor në raport me blegtorinë veçanërisht në fshatra me reliev fushor, ndërsa në fshatra në lartësi më të madhe mbi nivelin e detit është e zhvilluar blegtoria. Peza është një njësi administrative e cila ka të zhvilluar bujqësinë dhe blegtorinë, por vitet e fundit i ka shfrytëzuar këto potenciale në shërbim të aktiviteteve rekreative për banorët e zonës, por edhe për popullsinë urbane të Tiranës, duke nxitur në këtë mënyrë edhe zhvillimin e sektorit të tretë të ekonomisë. Një model i ngjashëm zhvillimi është aplikuar edhe për njësinë administrative Petrelë, duke shfrytëzuar burimet natyrore dhe aspektin historik të zonës.

Rrezja e tretë e ndikimit, me njësitë administrative Baldushk – Krrabë – Shëngjergj – Zall Bastar, mund të evidentohet si një kategori tipikisht rurale. Baldushku është njëra prej njësive administrative në të cilën zhvillohen aktivitete tërësisht rurale, lidhur me kushtet natyrore të territorit, duke bërë të mundur që popullsia e zonës jo vetëm të sigurojë produkte bujqësore për vetëkonsum, por edhe për tregtimin e tyre për banorët e zonave të tjera rurale përreth, si për qytetin e Tiranës. Pa dyshim që këto kushte natyrore kanë ndikuar edhe në shfaqjen e impulseve turistike, ku fshatrat në të cilët ndodhen monumente natyrore dhe kulturore (Mumajes Kodër, Shpat, Kakunjë), konsiderohen si destinacione tërheqëse për profile të ndryshme turistësh, ndonëse pesha e këtij sektori në ekonominë e zonës është ende shumë e ulët. Në të njëjtat ngjyime shfaqet edhe njësia administrative e Krrabës, e cila para viteve '90 ka qenë qendër e minierës së gypyrurit dhe më pas u zhvilluan produkte të cilat mbështetnin industrinë e lehtë tekstile dhe të veshjeve, megjithatë, kjo zonë ka një traditë të hershme të zhvillimit të blegtorisë, e cila ushtrohet edhe sot. Format e relievit dhe biodiversiteti i pasur mund ta kthejnë këtë territor në atraksion për turizmin malor dhe sportiv. Këto kushte fizike – gjeografike shfaqen edhe në njësinë administrative Shëngjergj, ku klubet e ndryshme të aktiviteteve “outdoor” në

kryeqytet organizojnë tashmë vizita turistike, megjithatë zona njihet më së shumti për produktet bujqësore lokale cilësore. Nga ana tjetër, karakteristikë e zonës është edhe tradita e thurjes së qilimave.

Në këto kushte, duke ridimensionuar profilin ekonomik të njësive rurale të bashkisë Tiranë, sipas rrezes së ndikimit të qendrës kundrejt periferive, përftojmë grafikun e mëposhtëm (Fig. 2).

Figura 2. Profili ekonomik i njësive administrative rurale të bashkisë Tiranë sipas rrezes së ndikimit



Burimi: Ilustrim i autorëve


Në kategorinë e parë të rrezes së ndikimit të qytetit të Tiranës drejt periferive të saj, konstatohet një dominim i sektorit të tretë të ekonomisë, pra shërbimet. Kjo zonë shërben si zonë e preferuar banimi, duke krijuar një marrëdhënie të ngushtë midis cilësisë së shërbimeve apo aktiviteteve të qendrës me periferinë e saj. Kategoria e dytë përfaqëson njësitë administrative rurale të cilat po bëjnë përpjekje për të patur një ekonomi të zhvilluar, por pa humbur identitetin e tyre rural. Në këtë mënyrë, si rezultat i hapësirave të lira, mundësisë për të zhvilluar bujqësinë, por edhe mundësisë për të shfrytëzuar potencialet natyrore të zonave, kjo kategori ka një natyrë mikse të profilit ekonomik, ku padyshim pesha kryesore mbahet nga sektori i bujqësisë, por me një zhvillim të rëndësishëm edhe të sektorit të turizmit. Ndërkohë, kategoria e tretë, me rreze ndikimi më të zbehtë të qendrës, mbetet tërësisht rurale. Kjo kategori dominohet nga aktivitete të sektorit të parë të ekonomisë, edhe pse shfaqen impulse të zhvillimit të turizmit natyror. Megjithatë, aktualisht këto impulse të zhvillimit të turizmit mbeten ende të pafuqishme.

Bashkëpunimi territorial midis njësive administrative rurale – urbane dhe rurale – rurale

Zonat rurale të bashkisë Tiranë kontribuojnë në ekonominë e qytetit nëpërmjet bujqësisë apo edhe turizmit; por vihet re edhe një mbështetje e qytetit ndaj zhvillimit rural nëpërmjet investimeve dhe infrastrukturës. Në anketimin e realizuar, për qëllime studimore, për të zbuluar marrëdhënien reciproke midis territoreve, u evidentuan disa konstatime. Moshat e përfshira në realizimin e pyetësorit ishin të kategorizuara në katër grupe. Pjesëmarrësit dominues i përkisnin grupmoshës 31-50 vje□ me 49%, duke u pasuar nga grupmosha 51-65 vje□ me 21%, grupmosha 18-30 vje□ me 20%, si dhe mbi 65 vje□ me 10%. Në kontekstin gjinor, në anketim, u përfshinë 59% meshkuj dhe 41% femra. Për të kuptuar lidhjen e banorëve me zonën përkatëse rurale, të anketuarit janë pyetur se prej sa kohësh banojnë në këto njësi. Sipas të dhënave të përftuara, 57% e të anketuarve janë vendas në zonë, 22% e të anketuarve që kanë mbi 20 vite banues në atë zonë, 14% e të anketuarve janë banues midis 10-20 viteve, ndërsa ata që kanë më pak se 10 vite që banojnë në zonë përfaqësojnë vetëm 5% të të anketuarve.

Për të identifikuar zhvillimet e zonës, të anketuarit janë pyetur se cili prej sektorëve të ekonomisë është më i zhvilluar në atë zonë. Sipas perceptimeve të tyre, ka rezultuar se 59% janë të mendimit se zhvillimet më të larta i përkasin sektorit të bujqësisë dhe blegtorisë, 26% citojnë sektorin e shërbimeve dhe veçanërisht turizmin, ndërsa 15% veçojnë sektorin e industrisë përpunuese dhe të lehtë. Nga ana tjetër, vihet re një përmbysje e rezultateve për peshën që zënë këto sektorë në punësimin e banorëve të zonës. Sipas të dhënave, peshën dominante të punësimit e mban sektori i tretë i ekonomisë (shërbimet dhe turizmi) me 35%, bujqësia dhe blegtoria me 32%, si dhe industria përpunuese dhe e lehtë me 32%. Kjo reflekton lidhjen që banorët e zonës kanë me qendrën, ve□anërisht në punësimin e tyre, ku pjesa më e madhe e popullsisë e cila punon në sektorin e tretë, është e drejtuar drejt qendrës. Pyetjes “A shkoni shpesh në qytetin e Tiranës”, 83% i janë përgjigjur “Po”, dhe 16% i janë përgjigjur “Jo”. Për të matur ritmin e lëvizjes drejt Tiranës, të anketuarit janë pyetur mbi shpeshtësinë e lëvizjes së tyre nga zona ku banojnë drejt qytetit. Sipas rezultateve, 35% e të anketuarve kanë pohuar se lëvizin □do ditë drejt qytetit, 22% dy herë në javë, 22% një herë në javë, ndërsa shpeshtësia dy herë dhe një herë në muaj rezultojnë përkatësisht me nga 12%. Nga të dhënat e siguruar nëpërmjet ArcGIS Survey123, janë përftuar edhe vizualizimet përkatëse. Konkretisht, për lëvizjen e të anketuarve drejt qytetit të Tiranës dhe shpeshtësinë e lëvizjes së tyre, janë përftuar grafikët e mëposhtëm.


Grafiku 1. Lëvizja e të anketuarve drejt qytetit të Tiranës



Burimi: World Living Atlas_Esri

Nga të dhënat sasiore të pyetësorit rezultoi se 83% e popullsisë së anketuar janë përgjigjur se ata lëvizin drejt qytetit të Tiranës. Nëpërmjet grafikut të mësipërm paraqiten vizualisht hapësirat gjeografike, apo zonat rurale, në të cilat të anketuarit lëvizin (pikat e kuqe) ose jo (pikat blu) drejt qytetit të Tiranës, ndërsa heksagonet me ngjyrë më të thellë tregojnë se në ato zona shpeshësia është me e lartë. Konstatohet se, në zonat më afër qendrës, banorët e anketuar kanë predispozitë të lëvizin më shpesh drejt qytetit të Tiranës. Kjo dëshmon jo vetëm lehtësitë e lidhura me distancën e territoreve nga qendra, por edhe ndikimin e infrastrukturës së zonave rurale në jetën e përditshme të banorëve.


Grafiku 2. Densiteti i lëvizjes së të anketuarve drejt qytetit të Tiranës



Burimi: World Living Atlas_Esri

Në grafikun e mësipërm, në të cilin është përfutur një kombinim midis shpeshtësisë dhe faciliteteve (lehtësirave), identifikohen zonat me shpeshtësinë më të lartë të lëvizjes drejt qytetit të Tiranës (ngjyra më e thellë), si dhe janë mbivendosur lehtësirat e arritshme që mbështetin udhëtimin drejt qytetit të Tiranës deri në 5 milje. Nëpërmjet grafikut evidentohet qartë se shpeshtësia e lëvizjes është më e rrallë në zonat ku nuk ka lehtësira, si p.sh infrastruktura e duhur fizike apo transporti publik cilësor. Facilitetet janë përlllogaritur në kohë reale me kombinim të kohës së mbërritjes së popullsisë në qendër dhe trafikut rrugor të zonës.

Grafiku 3. Intensiteti (denduria) e lëvizjes së të anketuarve drejt qytetit të Tiranës e matur me të dhënat e trafikut



Burimi: World Living Atlas_Esri

Të dhënat e trafikut janë matur gjithashtu edhe me intensitetin (dendurinë) e lëvizjes së të anketuarve drejt qendrës së qytetit të Tiranës, duke i mbivendosur edhe shtresën e linjës rrugore të zonës. Sipas të dhënave, hekzagonët me ngjyrë më të thellë kanë denduri më të lartë të lëvizjes së popullsisë së anketuar.

Për të analizuar arsyet se përse popullsia banuese në njësitë rurale lëviz drejt qytetit të Tiranës, të anketuarve i është drejtuar pyetja se “Cilat veprimtari kryeni në qytet?”. Banorët kanë patur mundësinë të përzgjedhin më shumë se një alternativë të dhënë dhe, në bazë të rezultateve, renditja nis nga shërbimet shëndetësore deri në kryerjen e veprimtarive administrative të nevojshme në përditshmëri.

Tabela 1. Renditja e veprimtarive që të anketuarit kryejnë në qytetin e Tiranës


Renditja	Veprimtaria	Rezultatet (%)
1	Shërbime shëndetësore	52
2	Furnizim ushqimor	51
3	Argëtim	45
4	Vizitoni të afërmit tuaj	36
5	Punësim	28
6	Arsimim	22
7	Veprimtari administrative	8

Burimi: Të dhënat e pyetësorit

Konstatohet se popullsia e anketuar lëviz më shumë drejt qytetit të Tiranës për shërbime shëndetësore dhe furnizim ushqimor. Këto shërbime ofrohen edhe në njësitë e tyre rurale, por cilësia e shërbimit apo produktit e nxit popullsinë të udhëtojë drejt qendrës. Nga ana tjetër, veprimtaritë administrative zënë përqindjen më të ulët midis arsyeve përse popullsia mund të lëvizë drejt qendrës, si rezultat edhe i digjitalizimit të disa prej shërbimeve të cilat mund të kryhen në kohë reale nga qendrat e vendbanimeve të të anketuarve.

Për të zbuluar bashkëpunimin midis territoreve, të anketuarit janë pyetur edhe nëse ata kryejnë aktivitete ekonomike, sociale apo kulturore në njësitë e tjera rurale të bashkisë. Nëpërmjet të dhënave sasiore ka rezultuar se 67,6% e të anketuarve kryejnë aktivitete të ndryshme edhe në njësitë e tjera administrative rurale.

Grafiku 4. Bashkëpunimi midis territoreve në njësitë rurale të bashkisë Tiranë sipas të anketuarve



Burimi: World Living Atlas_Esri

Vihet re se bashkëpunimi apo aleanca midis territoreve varet ngushtë nga distanca e tyre, duke e kthyer pozitën gjeografike në një faktor shumë të rëndësishëm në marrëdhënien reciproke territoriale. Sipas të dhënave të vizualizuara, vihet re se marrëdhëniet reciproke më të intensifikuara midis territoreve janë në njësitë administrative Kashar – Vaqarr ; Vaqarr – Ndroq; Kashar – Ndroq; Dajt – Zall Bastar; Zall Bastar – Zall Herr; Dajt – Shëngjergj; Petrelë – Farkë; Petrelë – Dajt.

Për pyetjen se sa e vlerësonin të anketuarit bashkëpunimin e njërive të tyre rurale me njësitë e tjera rurale, bazuar në një shkallë nga 1 në 10, rezultoi një mesatare prej 5,72. Ndër aspektet pozitive të këtij bashkëpunimi u renditën: përmirësimi i infrastrukturës, hapja e aktiviteteve të reja ekonomike, diversifikimi i shërbimeve, zhvillimi i tregtisë dhe rritja e shkëmbimeve, rritja e punësimit, si dhe aksesimi më i shpejtë në veprimtaritë sociale. Si aspekt dizavantazhues, të anketuarit kanë renditur shpërndarjen e popullsisë, të cilët preferojnë të zhvendosen nga zona origjinë në një tjetër zonë ku ofrohen kushte më të mira punësimi dhe banimi. Megjithatë, të anketuarit shprehen optimistë për të ardhmen e bashkëpunimit midis territoreve, veçanërisht në aspektin ekonomik.

Roli i aktorëve lokalë në bashkëpunimin territorial midis njësive administrative të bashkisë Tiranë

Në çdo hapësirë gjeografike, veçanërisht aty ku ushtrohet veprimtaria e njeriut në mënyrë të intensifikuar, ka nevojë për ndërveprim midis aktorëve të ndryshëm të cilët janë të përfshirë në përdorimin, vendimmarrjen dhe zhvillimin e një territori. Ky ndërveprim ndihmon në sigurimin e zhvillimit të qëndrueshëm dhe harmonizim të politikave jo vetëm për territorin ku ushtrohen këto funksione, por edhe më gjerë. Disa nga aktorët më të rëndësishëm që duhen përfshirë në vendimmarrjen e territorit janë administratat e njësive administrative, organizatat joqeveritare (OJQ), sipërmarrjet lokale, si dhe qytetarët. Në kontekstin e bashkëpunimit territorial, këta aktorë luajnë rol të rëndësishëm në forcimin e lidhjeve midis zonave qendrore dhe periferike të bashkisë Tiranë për të zvogëluar hendekun e zhvillimit të barabartë midis njësive administrative. Nëpërmjet pyetësorit, vihet re se një prej elementeve më të spikatura për ndërhyrje nga instancat përkatëse është zhvillimi i mëtejshëm i infrastrukturës, veçanërisht zgjerimi dhe përmirësimi i linjave të transportit publik që lidhin zonat periferike me qendrën. Nga ana tjetër, duhet të nxitet promovimi i zhvillimit ekonomik dhe i investimit në zonat periferike, duke ofruar stimuj për bizneset që investojnë në zonat periferike për të krijuar mundësi punësimi dhe zhvillimi ekonomik në atë zonë. Në këtë rast, mund të krijohen qendra tregu dhe shërbimesh në zonat periferike, që do të reduktonin varësinë nga qendra dhe do të zhvillonin ekonominë lokale. Një tjetër element shumë i rëndësishëm është përfshirja

e komunitetit dhe pjesëmarrja në vendimmarrje. Aktorët lokalë mund të organizojnë takime midis përfaqësuesve të zonave qendrore dhe periferike për të diskutuar dhe koordinuar politikat dhe projektet. Në këtë mënyrë, banorëve nga njësi të ndryshme administrative (rurale/urbane) do t'u garantohet përfaqësimi dhe adresimi i nevojave, veçanërisht në sigurimin e aksesit në shërbimet të njëjta publike, përfshirë shëndetësinë, arsimin dhe kujdesin social, por edhe zhvillimeve ekonomike që vijnë si rezultat i bashkëpunimeve territoriale. Ky bashkëpunim duhet të shihet gjithmonë me qëllimin për të përmirësuar shërbimet publike, për të promovuar zhvillimin ekonomik dhe për të rritur cilësinë e jetës për banorët në të gjitha njësitë administrative, si në ato urbane, ashtu edhe në ato rurale. Pyetësi i realizuar me banorët e zonës evidentoi mungesën e prezencës së herpashershme të aktorëve vendimmarrës në realizimin e projekteve të ndryshme, ku terriore të caktuara rurale të përfshiheshin në programe zhvillimi, si për promovimin dhe tregtimin e produkteve bujqësore që ata mund të prodhojnë, ashtu edhe për resurset turistike që këto zona ofrojnë.

Sfidat për një bashkëpunim produktiv territorial midis zonave të bashkisë Tiranë

Bashkëpunimi territorial i suksesshëm kërkon një kuptim të qartë të sfidave dhe objektivave të përbashkëta²². Me qëllim që të arrihet një zhvillim progresiv pozitiv, për secilën prej njësive administrative, urbane apo rurale, kërkohet një bashkëpunim tolerant dhe mirëkuptues nga të gjithë aktorët. Megjithatë, nëse gjenden pika konvergimi, padyshim që njësitë administrative mund të bëjnë përpjekje për të përmirësuar kushtet sociale dhe ekonomike që ato ofrojnë. Këto bashkëpunime nuk janë lehtësisht të arritshme, pasi secila prej njësive administrative përballet me kushte specifike sociale dhe ekonomike, ndaj për arritjen e një zhvillimi të balancuar dhe të qëndrueshëm territorial, ndeshen disa sfida. *Së pari*, një prej sfidave kryesore është pabarazia ekonomike dhe sociale, ku njësitë urbane kanë një zhvillim më të lartë ekonomik, dhe njësitë rurale për shkak të nivelit të lartë të papunësisë dhe varfërisë, sjellin mungesë të burimeve të nevojshme për të mbështetur projekte të përbashkëta me zonat qendrore. *Së dyti*, mungesa e infrastrukturës së zhvilluar, konsiderohet një tjetër sfida e bashkëpunimit territorial, kjo sepse vështirëson bashkëpunimin dhe aleancat midis terrioreve. Infrastrukturat e pamjaftueshme të transportit dhe lidhjet e kufizuara midis zonave qendrore dhe periferike sjellin zbehje të marrëdhënieve midis njësive administrative. *Së treti*, fragmentimi administrativ apo mungesa e një koordinimi efektiv midis njësive të ndryshme administrative cënon zbatimin e projekteve të përbashkëta. Kur procedurat janë të komplikuar, por edhe kur institucionet nuk harmonizojnë rregulloret përkatëse, padyshim që krijohen pengesa

²² Chamusca, P, "Territorial cooperation and cross-border development: The Portuguese dynamics", *Social Sciences* 13, no. 2, 2024, f. 108, <https://doi.org/10.3390/socsci13020108>.

në përparimin e bashkëpunimit territorial. *Së katërti*, mungesa e pjesëmarrjes dhe e përfshirjes së komunitetit paraqet një tjetër sfidë. Qytetarët duhet të kërkojnë të jenë më të pranishëm në vendimet që merren për territorin ku ata jetojnë dhe ushtrojnë veprimtaritë e tyre. *Së pesti*, burimet e kufizuara financiare dhe teknologjike reduktojnë mundësitë për zbatimin e projekteve të përbashkëta dhe përmirësimin e infrastrukturës në zonat periferike, ashtu si edhe mungesa e qasjes në teknologji pengon përparimin në bashkëpunimin dhe zhvillimin territorial. Në njësitë rurale të bashkisë Tiranë kjo është një ndër sfidat që shpeshherë preket edhe nga aktorët lokalë të njësive administrative, të cilët theksojnë se njësitë përkatëse nuk kanë fuqi plotësisht vendimmarrëse, si dhe kanë një mungesë të theksuar të autonomisë.

Përfundime

Bashkëpunimi territorial, i njohur edhe si «aleanca territoriale,» po bëhet gjithnjë e më i rëndësishëm për zhvillimin lokal dhe rajonal, duke u fokusuar në shfrytëzimin e potencialeve të ndryshme të territoreve urbane apo rurale. Kjo aleancë bazohet në bashkëpunimin reciprok mes territoreve të ndryshme për të promovuar zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik dhe social të një hapësire gjeografike. Nga pyetësorët e kryer, rezulton se shumica e të anketuarve të zonave rurale kanë lidhje të forta me qendrën, veçanërisht në aspektin e punësimit, ku 35% e të anketuarve punojnë në sektorin e shërbimeve dhe turizmit, ndërsa 32% në bujqësi dhe blegtori. Sa më afër qendrës të jetojnë banorët, aq më shpesh ata udhëtojnë drejt qytetit të Tiranës, duke reflektuar rëndësinë e distancës dhe infrastrukturës në këto lëvizje. Bashkëpunimi ndërmjet territoreve duket se është më i intensifikuar në njësitë administrative që janë më pranë njëra-tjetrës, si Kashar-Vaqarr apo Dajt-Zall Bastar, ndërsa mungesa e infrastrukturës fizike dhe transporti publik jo-cilësor kufizon lëvizjet dhe bashkëpunimin me zonat më larg qendrës. Sfidat janë të shumta, për një bashkëpunim të suksesshëm, ndër to përmendim pabarazinë ekonomike dhe sociale, mungesën e infrastrukturës, koordinimin e dobët midis njësive administrative, mungesën e përfshirjes së komunitetit dhe burimet e kufizuara financiare dhe teknologjike. Këto faktorë pengojnë zhvillimin e projekteve të përbashkëta dhe promovimin e produkteve bujqësore dhe turizmit në këto zona. Megjithatë, për të arritur një zhvillim të balancuar dhe të qëndrueshëm territorial, është e nevojshme të kapërcehen këto sfida për të krijuar mundësi më të shumta për bashkëpunim dhe zhvillim të qëndrueshëm territorial.

Referenca

Beck. J, “Transdisciplinary Discourses on Cross-Border Cooperation in Europe”, *Peter Lang Bruxelles*, 2019, f.13.

Capello. R, “Cohesion policies and the creation of a European identity: The role of territorial identity”, *JCMS: Journal of Common Market Studies* 56, no. 3, 2018, f. 489–503, <https://doi.org/10.1111/jcms.12611>.

Chamusca. P, “Territorial cooperation and cross-border development: The Portuguese dynamics”, *Social Sciences* 13, no. 2, 2024, f. 108, <https://doi.org/10.3390/socsci13020108>.

Regnacq. Ch, «Impact d’un risque technologique majeur dans l’attractivité des territoires», *Hyper Article en Ligne - Sciences de l’Homme et de la Société*, 2018, f. 10, <https://hal-univ-pau.archives-ouvertes.fr/hal-02141061/document>.

Dabove. P, Pietra. V. D, Piras, M. “GNSS positioning using mobile devices with the android operating system”, *ISPRS International Journal of Geo-Information* 9, 2020, f. 220, <https://www.mdpi.com/2220-9964/9/4/220>.

Durand. F, Decoville. A, “A multidimensional measurement of the integration between European border regions”, *Journal of European Integration* 42, no. 2, 2020, f. 163–178, <https://doi.org/10.1080/07036337.2019.1657857>.

Fargher. M, “WebGIS for Geography Education: Towards a GeoCapabilities Approach”, *ISPRS International Journal of Geo-Information* 7, 2018, f. 111.

Gasparini. A, “Belonging and identity in the European border towns: Self-centered borders, hetero-centered borders”, *Journal of Borderlands Studies* 29, 2014, f. 165–201, doi:10.3390/ijgi7030111 www.mdpi.com/journal/ijgi.

Guillermo-Ramirez. M, “The added value of european territorial cooperation: Drawing from Case Studies”, *European Territorial Cooperation*, edited by E. Medeiros, 2018, f. 25–47.

Kosovrasti. A, Zhvillimi i qëndrueshëm i komunave Dajt dhe Bërzhitë (studim krahasues), *Disertacion*, Universiteti i Tiranës, 2014, f. 24, <https://unitir.edu.al/wp-content/uploads/2014/09/Doktoratura-Albana-Kosovrasti-Fakulteti-i-Historise-dhe-i-Filologjise-Departamenti-i-Gjeografise.pdf>.

McMaster. I, Maguire. R, “Territorial cooperation: Widely pursued and widely questioned”, *EoRPA Report 23/4*, *European Policies Research Centre*, University of Strathclyde and EPRC Delft, 2023, https://eprc-strath.org/wp-content/uploads/2023/12/Territorial-Cooperation-EoRPA-report-23_4-ISBN.pdf.

Medeiros. E, Scott. J, Ferreira. R, Boijmans. P, Verschelde. N, Guillermo-Ramírez. M, Soares. A, “European territorial cooperation towards territorial cohesion?” *Regional Studies* 58, no. 8, 2023, f. 1518–1529, <https://doi.org/10.1080/00343404.2023.2226698>.

Secrétariat d’Etat chargé de l’économie sociale et solidaire et de la vie associative, Acteur: Les Associations, *Fiche Pratique du «Faire Alliance»*, 2022, <https://www.lerameau.fr/wp-content/uploads/2022/09/Fiches-Pratiques-Associations-EXE.pdf>.

Secrétariat d’Etat chargé de l’économie sociale et solidaire et de la vie associative, «Acteur: Les collectivités territoriales », *Fiche Pratique du «Faire Alliance»*, 2022, <https://www.lerameau.fr/wp-content/uploads/2022/09/Fiches-Pratiques-Collectivites-EXE.pdf>.

Secrétariat d’Etat chargé de l’économie sociale et solidaire et de la vie associative, «Acteur: Les Entreprises », *Fiche Pratique du «Faire Alliance»*, 2022, <https://www.lerameau.fr/wp-content/uploads/2022/09/Fiches-Pratiques-Entreprises-EXE.pdf>.

Secrétariat d’Etat chargé de l’économie sociale et solidaire et de la vie associative, «Acteur: Les Fondations», *Fiche Pratique du «Faire Alliance»*, 2022, <https://www.lerameau.fr/wp-content/uploads/2022/09/Fiches-Pratiques-Fondations-EXE.pdf>.

Sinjari. S, Kosovrasti. A, “Geography Students’ fieldwork with ArcGIS Survey123 for the assessment of human pressure in protected areas”, *Studime Albanologjike*, no. 1, 2023, ISSN Print 2305-3828, ISSN Online 2959-9695, f. 34, <https://studimeapi.gridcoding.com/uploads/materials/1703590967219.pdf>.

Sibieude. Th, «Les Alliances Qui Changent les Territoires: Partenariats Entre Acteurs Publics, Acteurs Privés et Structures d’Intérêt Général pour le Bien Commun », 2020, <https://impactinitiative.essec.edu/index.php/developpement-local/>.

While. A, Gibbs. D, Jonas. A, “The competition state, City-Regions, and the territorial politics of growth facilitation”, *Environment and Planning A: Economy and Space* 45, 2013, 2379–98.